

8SH-1

SHKRIMTARË AMATORË
DHE RAPSODË POPULLORË

17 57

TOM NIKOLLA

*Lum për
popullin
shqypitar!...*

891.983-1

TOM NIKOLLA

5'

7157

LUM PËR POPULLIN SHQYPTAR!..

34693

~~33164~~

SHKOLLJA E SHTETIT
GJITHKOSHTET

PARATHËNIE

Me këtë vëllim Shtëpia Botonjëse «Naim Frashëri» fillon serinë e botimeve titulluar «Shkrimtarë amatorë dhe rapsodë popullorë», që do të përfshijë gradualisht gjithë krijimtarinë gojore dhe letrare masive të ditëve tona me tërë gjinitë dhe llojet e saj.

Kjo seri e vazhdueshme botimesh do të sjellë një shërbim të veçantë në zbatimin e porosisë së Plenumit XV të Komitetit Qendror të P.P.SH., për krijimin e një lëvizje letrare me proporcione të gjëra masive, që t'i shërbejë socializmit si mjet i shëndoshë për edukimin revolucionar, patriotik dhe estetik të gjithë punonjësve tanë të fshatit e qytetit.

Një nga kushtet e domosdoshme për revolucionarizimin e letërsisë është shtrirja e saj në masë, karakteri i saj popullor. Këto botime me shkrime nga masat punonjëse, më të interesuarat për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, do të sjellin në letërsi entuziazmin e tyre përshtypjet nga jeta e gjallë, ku ndërtohet socializmi, do të fusin kështu në jetën tonë letrare një notë të theksuar revolucionare. Këto shkrime të thjeshta por të qarta e të kuptueshme do të shprehin aspiratat socialiste

të popullit, si pasqyrë besnike e mendimit tonë të kohës, kur të gjitha forcat e shëndosha klasore dhe kombëtare të vendit janë mobilizuar për ndërtimin e socializmit nën udhëheqjen e Partisë së Punës, duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën.

Veç rolit edukativ revolucionar kjo seri botimesh do të ndihmojë edhe në thellimin e formës kombëtare të letërsisë e në përtëritjen masive të shijeve të veçanta për letërsinë e vendit e folklorin tonë me merita të larta artistike të njohura botërisht.

Bashkë me krijimet letrare më të frymëzuara do të futen në këto botime edhe shkrimet me vlerë artistike modeste, por me përmbajtje të shëndoshë socialiste dhe patriotike, se nga ky nivel nisen shpesh diletantët, po nga mezi i tyre dalin me kohë edhe kryevepra letrare dhe sepse, kur shkrimet letrare, qo'shin edhe pa merita të shquara artistike, por të pranueshme për shijen letrare të masave të gjera dhe u përgjigjen aspiratave të tyre politike, shoqërore, ato e luajnë më së miri rolin e tyre edukativ. Mjafton të përmendet se në kohën e Rilindjes sonë kombëtare, kur letërsira u vu tërësisht në shërbim të kësaj lëvizje patriotike si problemi kryesor i vendit, bashkë me veprat e shkrimtarëve tanë kryesorë, edhe veprat e shkrimtarëve të dorës së dytë e të tretë, që mbushën shtypin shqiptar periodik, çuan peshë entuziazmin patriotik në masë dhe vunë në garë njerëzit e thjeshtë, që sapo kishin mësuar shkrimin shqip, të provonin talentin e tyre sëpuri me vargje patriotike. Por, natyrisht rethanat e vështira si pushtuesi i huaj, analfabetizmi në masë,

mundësitë aqë të kufizuara të botimit etj. nuk mund të lejonin asi kohe krijimin e një lëvizje masive letrare, megjithëse entuziazmi patriotik ishte mjaft i fortë.

Sigurisht që sot, kur i tërë vendi ynë përshkohet nga një vrull i paparë revolucionar e patriotik, kur përparimet tona, nga çdo anë që t'i shokësh, kanë tejkaluar edhe parashikimet e rilindasit në të përparuar, kur arësimi dhe kultura jonë kombëtare socialiste kanë përfshirë tërë masën dhe lëvizja amatore letrare po shtrihet gjërësisht, kjo seri botimesh me karakter masiv do t'i gjejë të gjitha kushtet e favorëshme për ta lojtur siç duhet rolin e saj të rëndësishëm që i takon në jetën tonë letrare, duke i dhënë një shtrirje sa më të gjërë dhe një puls të ri revolucionar lëvizjes sonë letrare.

Fillimi i kësaj serie me vëllimin e Tom Nikollës «Lum për popullin shqyptar!» që i rastit, si vëllim i parë që u ndodh i përgatitur për botim. Pas vëllimit «Shndriti rrezja në malsi», botuar më 1961, ky është i dyti me vjersha të Tom Nikollës, të cilat dallohen për një tematikë më të gjerë e një rrjedhshmëri teknike më të sigurt nga ato të vëllimit të parë. Këto janë vjershat të një rapsodi, që kanë lindur bashkë me melodinë nëpër telat e çiftelisë dhe në përgjithësi i ruajnë tiparet metrike dhe figurative të rapsodive tona popullore tradicionale, megjithëse duken qartë e shpesh ndikimet e kohës. Autori dallohet veçanërisht në përdorimin e qëlluar të shprehjeve satirike dhe sentencave popullore, për të demaskuar me ironi e sarkazëm demagogjinë e armikut imperialist e revizionist.

Te këto këngë të frymëzuara nga ngjarje të

shënuara brenda dhe jashtë vendit tonë, ndjenet
qartë patriotizmi i masave tona punonjëse, entu-
siazmi për fitoret tona socialiste, mburrja e li-
gjëshme për vendosmërinë, trimërinë, vigjilencën
e popullit tonë të udhëhequr nga Partia në luftë
me vështirësitë e ecjes përpara për ndërtimin e
socializmit dhe kundër armikut, që kërkon më
kot të na pengojë. Sipas rastit autori merr shkas
nga festat e mëdha dhe i këndon plot krenari tra-
ditës sonë të luftës për liri, herojve të hershëm e
të rinj, udhëheqësve tanë të mëdhenj, përgjithë-
sisht jetës sonë të re, që po lulëzon me tërë bu-
kurinë e saj.

DH. F.

N'MAJE TË NALTA DO T'MARSHOJME

Nën këtë qiell e mbi këtë dhe,
Plot me gas e me hare
Po ndërtojmë Shqypnin' e re.

Nji nandor Shqypnia n'festë
Për Kongresin e saj t'pestë.
Nga kongresi në kongres
Gjithmonë duelëm me sukses.
Çerek sheklli, moj Parti,
Nëpër luftë, nëpër stuhi... ,
Veç fitore na dhe ti.

Moj Parti buzë Adriatikut,
Je e fortë porsì çeliku,
Je e rreptë kundra anmikut,
Je e pastër si kristali,
Je e shpejtë si Shqype mali.

Me trimi fillove punën,
Me guxim prite furtunën,
Në çdo mbledhje, n'shejë peshqeshit,
U nxorre armiqve laknat sheshit.

S'u le ftyrë e s'u le bojë,
I ke lanë me gisht në gojë.

I pari n'krye kti timoni,
Enver Hoxha, trim drangoni,
Gjithmonë ka drejtue me nder,
T'tanë anmiqt e kanë marrë tmer.
Çdo fortun' nga toka a deti,
Dymdhet' ballësh me ra termeti,
Nuk e tund, ma sa luen krepri.

Zien kanali nga Bistrica,
Ushtojnë malet nga Gjalica.
Po tund tokën ekspedita,
Tymn n'qiell po e çon fabrika.
Roje t'fortë ka Rrepublika;
S'kanë ç'na bajnë anmiqt as Tita,
Hrushovjant as Amerika.

Ah medet se çka me pa!
Hrushovjant sa poshtë kanë ra:
Kur Vjetnami n'gjak tuj u la,
Amerikës i thrasin vlla.
Lamsh e li e kanë ba planin,
Lusin Zotin, Vatikanin,
Nesër n'r:jes janë me shejtanin;
Pesqind gradë kanë kthye për mprapa,
Shkojnë e lypin paqë ke Papa.

Kudo n'botë ka ba jehonë
Vija e drejtë e Partisë sonë:

Kem' një shemull në Okebe 1)
Fjala e Shqypes ra si rufe.
Ktu Shqypnia e mori fjalën,
Donë me e ndalë, po s'mun' e ndalën;
Si ndojherë kur bjen rrufeja,
U ba rrëmuq krejt Okebeja.
Sekretarit t'Okebesë
Gadi i luejtën ment e kresë.
Kaq Shqypnia u kallu tmerën,
Çohen n'kamë e s'e gjejnë derën;
Do gjejnë derën për me dalë,
Kërkojnë t'falun për me i falë.
Prap Shqypnia u tha një fjalë:
Me shqyptarë nuk ka shumë fjalë,
Sa për frigë mos t'qofshim falë,
Kemi t'drejtën dëshmitar,
Kemi një gjithë popujt marë.

Letra e hapun e Partisë
Asht pasqyrë e lumtunisë.
Ne na dalin shumë detyra
Me u kalitë për raste t'vështira;
Fushë e kodër me shfrytzue,
Bukën n'vend me sigurie,
Kemi dy sy, t'i bajmë gjashtë,
Mos ta mlojmë t'zezën me kashtë,
Sa ma pak import nga jashtë.

1) Lidhur me fjalimin e delegatit tonë, H. Budos në O.K.B. me 16.II.1965 kundër përpjekjeve amerikane për t'u mohuar të drejtën e votës disa shteteve anëtare.

N'katër anët poplli shqyptar,
I madh e i vogël asht ushtar,
Për me mrojtë fitoret tona,
Me ndërtue me forcat tona,
Mos me fletë ma se Valbona; 1)
N'kokë anmikut me i ra spatë,
Pushkën n'dorë, barutin t'thatë,
N'tjetrën dorë kazëm, lopatë.

Shpesh Partia e ka thanë:
Kundr' anmikut gjithnji n'kamë.
Thik' për thikë me imperjalizmin,
Dham' për dhamë revizionizmin!
Kto fitore do t'i mprojmë,
Çdo blokadë do e shpartallojmë,
Për marksizmin do luftojmë,
N'maja t'nalta do marshojmë!

1) ma se Valbona — ma se flenë lumi Valbona.